

VENDIM
Nr.199, datë 25.5.1990

**PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE SHTETËRORE PËR ÇMIMET
DHE TARIFAT**

Në zbatim të ligjit nr.7374, datë 8.5.1990 "Për çmimet dhe tarifrat", me propozimin e Komisionit të Planit të Shtetit dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteria të përgjithshme

1. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në caktimin e çmimeve dhe të tarifave për produktet dhe mallrat kryesore, zbatojnë parimin e kolegjalitetit, me qëllim që të ruhen interesat e shtetit, të prodhuesit e të konsumatorëve. Në komitete ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve byrotë e çmimeve të kenë në përbërjen e tyre përfaqësues të seksioneve të financës, të tregtisë, të bujqësisë, të industrisë, të ekonomisë komunale etj.

2. Organet shtetërore që miratojnë çmime shitjeje me shumicë e me pakicë, mbështeten në propozimin e organeve prodhuese, duke zbatuar këtë strukturë kryesore të çmimeve:

- a) Kostoja e plotë për njësi.
- b) E ardhura neto e ndërmarrjes.
- c) Çmimi me shumicë i ndërmarrjes.
- ç) E ardhura neto e centralizuar e shtetit.
- d) Çmimi me shumicë i degës.
- dh) Rabati i tregtisë.
- e) Çmimi i shitjes me pakicë.

3. Në industri e ardhura neto e centralizuar diferencohet sipas produkteve, llojit, cilësisë, përmbajtjes së lëndëve të dobishme në mineralet etj.

Në bujqësi çmimet me shumicë mbajnë parasysh koston për njësi të prodhimit të tokave me pjellori të ulët sipas zonave dhe diferencohen për produkte e ndërmarrje.

Për raste të veçanta, që përcaktohen nga Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministrinë e interesuara, çmimet me shumicë mund të caktohen edhe më të larta se çmimet e shitjes me pakicë.

4. Çmimet e blerjes së produkteve ujçësore e blegtorale dhe të mallrave industriale për eksport caktohen më të larta nga ato të vendit, në përputhje me leverdinë që ato kanë në tregjet e jashtme, duke mbajtur parasysh shpenzimet plotësuese që bëhen për përzgjedhjen, ambalazhimin, etiketimin, kërkesat e veçanta cilësore të tregut të jashtëm etj. Ato mund të diferencohen edhe për rrethe, në përputhje me ndikimet e rentës diferenciale dhe politikën sociale të shtetit për zhvillimin e harmonishën të të gjitha zonave.

5. Çmimet e shitjes me pakicë të gazetave, revistave, të botimeve të Akademisë së Shkencave dhe të botimeve letraro-artistike të mbulojnë në tërësi shpenzimet dhe të sigurojnë një rentabiliteti të arsyeshëm, duke lejuar kompensime brenda lojit të botimeve dhe të titujve. Çmimet, veç kostos, të mbajnë parasysh llojin e shtypit, të lidhjes, cilësinë, llojin e letrës etj.

Botimet politiko-shoqërore, shkollore dhe për fëmijë mund të caktohen edhe më të ulëta se kostoja e plotë.

Çmimet e shitjes me pakicë të librave, revistave, gazetave etj, që blihen jashtë shtetit, për nevojat e ndërmarrjeve, të institucioneve ose për popullin, caktohen në bazë të çmimit të blerjes në valutë të konvertuar në lekë me kursin ekonomik, ose edhe më të larta.

II.Procedura për miratimin e çmimeve

1. Propozimi në organet shtetërore për miratimin e çmimeve e të tarifave sipas kompetencave dhe emërtesës që ato kanë, bëhet:

a) Për Këshillin e Ministrave nga Komisioni i Planit të Shtetit, së bashku me ministrinë e institucionet e tjera qendrore, ose nga vetë ministrinë, pasi të jetë marrë mendimi i ministrive të interesuara.

b) Për Komisionin e Planit të Shtetit nga ministritë e institucionet e tjera qendrore, ose nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

c) Për ministritë e institucionet e tjera qendrore nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, si dhe nga ndërmarrjet e sistemit të tyre dhe kooperative bujqësore.

ç) Për komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve nga ndërmarrjet ose nga kooperativat bujqësore.

2. Propozimet për miratim çmimesh e tarifash të përmbajnë: analizën e kostos sipas zërave, të ardhurën neto të ndërmarrjes, të ardhuraën neto të centralizuar të shtetit, rabatin e tregtisë, çmimin e shitjes me pakicë dhe relacionin. Për prodhimet që eksportohen, propozimi të përmbajë koston në valutë, çmimet e shitjes me jashtë dhe leverdinë ekonomike. Propozimi shoqërohet, sipas rastit, me kampionin, modelin, skicën, fotografinë, katalogun etj. Nuk lejohet miratim çmimesh e tarifash me humbje për produktet, shërbimet dhe mallrat e reja.

3. Miratimi i çmimeve dhe i tarifave në ministritë e institucionet e tjera qendrore bëhet nga titullari, në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve nga byroja e çmimeve, në ndërmarrje nga drejtoritë dhe në kooperativa bujqësore nga kryesorë e tyre.

Çmimet e miratuara prej tyre evidencohen në regjistra themeltarë dhe komunikohen nëpërmjet buletineve të çmimeve.

III. Kompetencat e organeve shtetërore dhe të ekonomisë për caktimin e çmimeve e të tarifave

1. Këshilli i Ministrave miraton:

a) Çmimet e tarifave bazë të shitjes me pakicë të produkteve kryesore: të bukës, miellit, niseshtesë, orizit, makaronave, fasuleve, mishit, peshkut, qumështit, të nënprodukteve të tij (djathë, gjizë, gjalpë) të sheqerit, të yndyrnave ushqimore të energjisë elektrike, të qirave të ndërtesave të banimit e të ngrohjes së përqëndruar të tyre dhe të transportit të udhëtarëve e të punëtorëve.

b) Çmimet e blerjes të drithërave të bukës, të orizit, të fasules, të bimëve industriale dhe të dorëzimeve mbi plan të kufijve maksimalë të blerjes së perimeve e të frutave, tarifën kryesore të punimeve me SMT dhe të ujitjes.

c) Çmimet e blerjes e të shitjes me pakicë të arit, argjendit, pltit dhe të gurëve të çmuar.

ç) Kursin ekonomik të vlerësimit të veprimtarisë së tregtisë së jashtme dhe të mallrave të importit; kriteret kryesore të planifikimit të çmimeve me shumicë të pesëvjeçarit.

d) Ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë e të tarifave të emërtesës së vet dhe të ministrive.

2. Komisioni i Planit të Shtetit miraton:

a) Çmimet e shitjes me shumicë e me pakicë të materialeve kryesore të ndërtimit (lëndë druri, tulla, tjegulla, hekur, çelique, pllaka e tuba gresim enterniti, plastmasë, gozhdë e xhama).

b) Çmimet e blerjes e të shitjes me pakicë të mollëve, të darhdave dimërore, të agrumeve e të rrushit, brenda kufijve maksimalë të miratuar nga Këshilli i Ministrave; çmimet e blerjes së produkteve bujqësore që nuk janë në emërtesë të Këshillit të Ministrave, dhe çmimet e blerjes për eksport të produkteve bujqësore.

c) Marzhet e kuzhinës të ushqimit social e të albturizmit.

ç) Uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave me qarkullim të ngadalshëm e stok dhe të tarifave, në bashkëpunim me Ministrinë e financave dhe ministritë e interesaurave.

3. Ministria e Tregtisë së Brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë e financave dhe ministritë prodhuese, miraton:

a) Çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të përdorimit të gjerë të vendit e të importit, të cilat nuk janë në emërtesë të organeve të tjera; çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të papërdorura që vijnë në rrugën e tregtisë së jashtme e raste të tjera.

b) Marzhet e tjera të ushqimit social, tarifën e fjetjes e të shërbimit në hotele.

c) Çmimet e shitjes me pakicë të mallrave jashtë kërkesave të kohës (demode) të emërtesës së vet.

ç) Çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të reja që vijnë në rrugë doganore e në rrugë të tjera.

4. Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore,

miraton:

a) Çmimet e shitjes me shumicë të artikujve të rinj të vedit dhe të importit dhe të atyre që planifikohen për çdo pesëvjeçar, të ambalazheve qarkulluese, të produkteve e të mallrave që eksportohen, të makinerive, të pajisjeve të pjesëve të ndërrimit e të materialeve të veçanta të vendit dhe që importohen, sipas emërtesës që miraton vetë.

b) Marzhet e grumbullimit dhe rabatet e tregtisë.

5. Ministria e Ekonomisë Komunale, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, miraton:

a) Tarifat e qepjes së rrobave të gatshme, të trikotazheve e të këpucëve e sandaleve me porosi, të shërbimit të berberëve, të kozmetikës, të fotografëve, të qirave të vilave e të kabinave në plazhe dhe të pajisjeve të tyre, si dhe tarifa të tjera të rëndësishme.

b) Çmimet e shitjes me pakicë të artikujve të rinj të cilësisë së lartë.

6. Ministria e Bujqësisë miraton:

a) Çmimet e blerjes së bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë Ushqimore dhe Ministrinë e Tregtisë së Jashtme, kur ndryshimet nuk japin efekte ekonomike.

b) Çmimet e blerjes e të shitjes së fidanëve frutore e pyjore, të zogjve të inkubatorit, të farës së mëndafshit, të kafshëve të racës, të kafshëve të punës e të atyre për mbarështim.

c) Çmimet e shitjes me shumicë të farave që grumbullohen në vend (pa drithërat) dhe të shitjes së tyre (kur ka donacion, merret pëlqimi i Ministrisë së Financave); çmimet e shitjes së farave të importit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Komisionin e Planit të Shtetit.

7. Ministria e Mbrojtjes Popullore miraton:

a) Çmimet e shitjes me shumicë të produkteve me karakter ushtarak të vendit e të importit, të riparimeve të armatimit të teknikës luftarake, të botimeve të veçanta të tipografisë së vet për ushtrinë.

b) Çmimet e brendshme të shitjes së produkteve bujqësore e blegtorale që realizohen nga repartet ushtarake dhe ndërmarrjet bujqësore të ushtrisë.

8. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendore, duke marrë mendimin e Ministrisë së Financave miratojnë:

a) Çmimet e shitjes me shumicë të makinerive, të pajisjeve e të pjesëve të ndërrimit që prodhohen në seri për të tretë, të riparimeve të mëdha të mjeteve detare, të mekanizmave, të agregatëve e të mjeteve të transportit.

b) Çmimet e shitjes me shumicë të nënprodukteve të industrializuara për blegtorinë.

c) Çmimet e shitjes me pakicë të botimeve me karakter letrar, artistik, shkollor, politiko-shoqëror e tekniko-shkencor për vend e për eksport dhe për shërbime për të huajt; çmimet e shitjes me shumicë të prodhimit e të shumëfishimit të filmave, kufijtë minimalë e maksimalë të çmimeve të biletave të shfaqjeve artistike, kinematografike e të lojërave sportive.

ç) Çmimet e brendshme me shumicë e të likuidimit në naftë e në miniera.

d) Çmimet me shumicë e me pakicë të barnave të prodhura në vend ose të importuara, të këpucëve ortopedikë, të protezave në klinikat dentare, të aparateve të pajisjeve mjekësore, tarifat e shërbimeve mjekësore për të huajt, me vendet e të cilëve nuk kemi marrëveshje të ndërsjellta, uljen e çmimeve të barnave ose dhënien falas të tyre personave të veçantë me sëmundje të rënda, me pëlqimin e Komisionit të Planit të Shtetit e të Ministrisë së Financave.

dh) Çmimet e biletave të bagazheve për udhëtarët, në transportin automobilistik, hekurudhor, detar e lumor, për linjën ndërqytetare, çmimet e shërbimeve për udhëtarët në portet detare e aeroportet (ngarkim-shkarkim e transport malli), tarifat e shërbimit ajror (ulje, ngritje avioni), tarifat e transportit të jashtëm detar, automobilistik e hekurudhor dhe të shërbimeve të mjeteve hekurudhore në stacionet kufitare, tarifat e të gjitha llojeve të transportit të ngarkim-shkarkimit të mallrave të sistemit të Ministrisë së Transporteve.

e) Tarifat e shërbimeve postare, telefonike dhe telegrafike të brendshme e të jashtme.

ë) Tarifat e preventivimit të institucioneve me drejtim ekonomik.

9. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendore miratojnë:

a) Çmimet e shitjes me shumicë të ambalazhit paketues e qarkullues prej tekstili, çmimet e faturimit të prodhimeve me lëndë të parë të porositësit; çmimet me shumicë të makinerive, të pajisjeve dhe të pjesëve të këmbimit në seri të mëdha që përdorë brenda sistemit.

b) Tarifat e transportit automobilistik të parqeve të tyre. Çmimet e manualeve të preventivimit në ndërtim-montimit, të minierave, të naftës, të gjeologjisë, të komunales, të industrisë mekanike, të

punimeve të PTT, të rruga-urës etj.

c) Çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të përdorura që vijnë në rrugë doganore (nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave).

ç) Uljen e çmimeve me shumicë të lëndëve të para, të materialeve, të pjesëve të ndërrimit, të kimikateve e të barnave që janë stok në ndërmarrjet dhe institucionet e sisemit të tyre.

d) Çmimet e fjetjes e të shërbimeve për të huajt, çmimet e shitjes në lekë e në valutë të karburanteve, të artikujve të prodhuar në vend e të importuar që tregtohen në njësitë e albturizmit, çmimet e blerjes së frutave e të agrumeve edhe më të larta nga ato të tregt të brendshëm, në marrëveshje me ekonomitë prodhuese, marzhet për frutat, agrumet, embëlsirat.

dh) Çmimet e shitjes me shumicë e me pakicë në lekë e në valutë të veprave të artit dhe të artikujve kulturorë për brenda e jashtë, çmimet në lekë e në valutë të shërbimeve kulturore, për të huajt dhe çmimet e blerjes nga populli të artikujve kulturore:

10. Byrotë e çmimeve të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve miratojnë:

a) Çmimin e shitjes me shumicë e me pakicë të produkteve ushqimore, si gjellë e konservuar me parime, fërgesë e japrak, turshi, pekmez, rehani, pestil, threpsinë, fruta të thara e të sheqerosura. Lëngje frutash, shurupe, puding, të prodhimeve të sheqerit (karamele, llokume, bombone, biskota, gliko, reçe e komposto etj, të kësaj natyre me përdorim lokal.

b) Çmimet me shumicë e me pakicë të prodhimeve artistike prej bronzi, bakri, tunxhi (me përjashtim të arit, argjendit, platinë) të drurit, të kockës e të prodhimeve të NPA-ve.

c) Çmimet e shitjes me shumicë e me pakicë të gurit, të çakëllit, të rërës e të materialeve të tjera inerte, kur uk ka çmime të caktuara nga organet më të larta, si dhe të mallrave të provës.

ç) Çmimet e artikujve të importit nga tregtia kufitare, tarifat e shërbimeve komunale e tregtare për furnizimin e popullit në shtëpi e në plazhe.

dh) Uljen e çmimeve të shitjes me pakicë dhe të tarifave të shërbimeve komunale e tregtare të emërtesës së tyre (pa konfeksionet) dhe zhvlefëtsmin e mallrave demode të emërtesës së tyre.

e) Çaktimin e çmimeve të blerjes së rakisë nga oborri (jo më shumë se çmimi me pakicë pa rabat).

ë) Çmimet e plehut organik, të kashtës për ushqimin e kafshëve të shtrojeve të barit, të barit të thatë e të njomë, të silazhit, të çajit të mallit e të luleblirit.

f) Çmimet e blerjes dhe të shitjes me pakicë të vezëve e të patateve, brenda kufijve maksimalë të miratuar. Çmimet e blerjes së perimeve e të frutave, kur ekonomitë bujqësore dhe ndërmarrjet blerëse nuk janë të një mendimi.

11. Drejtoritë e ndërmarrjeve, në bazë të kriterëve të miratuar nga organet qendrore, miratojnë:

a) Çmimet e blerjes së frutave e të perimeve të njoma (pa emërtesën e organeve qendrore), në marrëveshje me ekonomitë bujqësore, brenda kufijve maksimalë të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

b) Çmimet e shitjes me pakicë të konfeksioneve (rroba të gatshme, veshje për veprimtari kulturore e sportive etj.) të trikotazheve të pambukta e akrilike.

c) Çmimet e shitjes me shumicë e me pakicë të prodhimeve me porosi me karakter individual për nevojat e ndërmarrjeve e të institucioneve, të shtypshkronjave, të kartografisë, të kartolerisë së prodhimeve jashtë standardit, të mbetjeve teknologjike e të prodhimeve të gatshme të prodhuara nga këto, kur shiten në dyqanet e tyre.

ç) Çmimet me shumicë të makinerive, të pajisjeve, të pjesëve të ndërrimit, të formave e të stampave, të pjesëve të rigjeneruara, të pjesëve të ndërrimit prej gome, plastike, të romonteve kapitale e të mesme nga ndërmarrjet e paspecializuara, në bazë të preventivit të pranuar nga ndërmarrjet, kooperativat dhe institucioni porositës, të suqhimin të kafshëve nga fabrikat e përpunimit.

d) Çmimet e grumbullimit të vjetërsirave e të sendeve të përdorura nga populli, ndërmarrjet, institucionet etj, për riaftësimin dhe çmimet me pakicë të tyre pas riaftësimit; çmimet e shitjes me pakicë të veshjeve të përdorura në veprimtaritë kulturore, sportive etj.

dh) Çmimet e shitjes me shumicë e me pakicë të prodhimeve të bardha prej druri, poçerisë, të llamarinës së zezë e të galvanizuar.

e) Çmimet e shitjes me pakicë të biletave të shfaqjeve artistike, kinematografike e të lojërave sportive, brenda kufijve maksimalë të miratuar nga institucioni qendror përkatës dhe Ministria e financave.

ë) Çmimet e shitjes me pakicë të prodhimeve të kuzhinës e të bankave, të pijeve freskuese e të embëlsirave, të pastave e të tortave të ushqimit social e të albturizmit.

f) Zhvleftësimin e mallrave jashtë kërkesave të kohës (demode) të emërtesës së tyre, efektet e të cilave përballohen nga rezultati ekonomik i tyre; çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të dëmtuara në depo e në rrjetin e tregtisë, pasi të kenë caktuar përgjegjësinë materiale të personave përgjegjës, pavarësisht nga emërtesa; çmimet e lojrave për fëmijë dhe të kinkalerisë të importit (nga baza e furnizimit të tregtisë në Durrës), çmimet e shitjes me pakicë të barnave të importit, kur ka ndryshim doze.

g) Tarifat e reja të riparim-shërbimit komunal, sipas emërtesës që i cakton ministria.

gj) Normativat e lëndëve të para e të materialeve për prodhimet në ushqimin social.

h) Çmimet e produkteve bujqësore e blegtorale që realizohen nga tufëzat e ngastrat sipas kostos faktike.

12. Kryesitë e kooperativave bujqësore, për anëtarët e tyre, miratojnë:

a) Çmimet e shitjes që rekomandon shteti për bukën, miellin, zahirenë, mishin, qumështin, leshin, lëkurët, fasulet.

b) Çmimet për perimet, frutat, bostanin, agrumet, rrushin, patatet, ullinjtë, arrat, bajamet, lajthitë, turshitë pekmezin, mjaltin, rehaninë, tullat, tjegullat, gëlqeren, zhavorrin, gurin, qymyrin drutë e zjarrit etj.

c) Çmime për blerjen e tepricave të oborreve dhe shitjen e tyre në dyqanet e kooperativave në qytet, të cilat mund të jenë edhe më të larta nga të shtetit.

ç) Çmimet e prodhimeve të kuzhinës për mensat e tyre, tarifat për shërbimet komunale (për rrobaqepësitë, berberët, etj, të kësaj natyre).

d) Çmimet për produktet bujqësore e blegtorale që realizohen nga tufëzat e ngastrat sipas kostos faktike.

13. Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe ministrinë e institucionet e tjera qendore përkatëse nxjerrin udhëzime e kritere për zbatimin e këtij vendimi.

14. Kreu I dhe dispozitat e tjera për çmimet e tarifat të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.85, datë 2.4.1987 “Për kriteret dhe kompetencat e organeve shtetërore për çmimet, standardet dhe kontrollin e cilësisë”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.3812, datë 19.10.1989 “Për përmirësimin e kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike në fushën e çmimeve të organeve shtetërore dhe ekonomike në fushën e çmimeve e të standardeve”, si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI